

Ka filluar punimet tryeza treditore me temën "Autonomia dhe llogaridhënia financiare e institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë"

Diskutojnë për mënyrat e financimit të arsimit të lartë

Në fillimin e punimeve të kësaj tryeze mbajtur të martën janë prezantuar mënyrat e financimit të arsimit të lartë në Kosovë, eksperiencat e partnerëve nga Evropa si dhe modelet e shpërndarjes së buxhetit. Tryeza treditore, organizohet në kuadër të projektit "Ngritja e autonomisë dhe llogaridhënies financiare në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë", financuar nga Komisioni Evropian nëpërmjet programit TEMPUS

EPOKA
ERE

Lirije KLAIQI

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Ka filluar punimet tryeza treditore me temën "Autonomia dhe llogaridhënia financiare e institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë", e cila ka për qëllim paraqitjen e mënyrave të financimit të arsimit të lartë publik. Në këtë tryezë mbajtur të martën janë prezantuar mënyrat e financimit të arsimit të lartë në Kosovë, eksperiencat e partnerëve nga Evropa si dhe modelet

e shpërndarjes së buxhetit. Tryeza treditore organizohet në kuadër të projektit "Ngritja e autonomisë dhe llogaridhënies financiare në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë", financuar nga Komisioni Evropian nëpërmjet programit TEMPUS.

Kjo tryezë ka për qëllim informimin për modelet e financimit nga vendet partnere si dhe gjetjen e një modeli të financimit të arsimit të lartë në Kosovë.

Drita Kadriu, këshilltare e ministrit në detyrë të Arsimit, Ramë

Buja, ka thënë se ky projekt mbështetet në zbatimin e Ligjit të Arsimit të Lartë, që do ta përcaktojë formulën e financimit në arsimin e lartë. "Ministria e Arsimit ka themeluar një grup punues, i cili do të punojë në definimin e formulës financiare dhe zhvillimin e infrastrukturës ligjore. Në dilemat se cila do të jetë mënyra e financimit të arsimit të lartë, që mbi një bazë të financimit që do të ishte 100 për qind, të inkurajohet arsimit i lartë, që përmes projekteve ta rrisin buxhetin e tyre dhe varësisht nga



kjo rritje të shtohen edhe fondet nga MASHT, ose marrja e fondeve dhe projekteve të jetë në bazën e 100-përqindëshit të financimit", ka thënë ajo.

Ndërsa Sophie Beaumont nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë është shprehur se projekti është i rëndësishëm për arsimin e lartë në Kosovë dhe se të priturat janë të mëdha sa i përket kësaj. "Kosova, institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë, do të mund të përfitojnë mjaft shumë nga praktikat më të mbara që ekzistojnë në shtetet e

Bashkimit Evropian dhe sigurisht autonomia në këto fusha mund të sjellë dobi për gjenerimin e të ardhurave, të cilat janë shumë të rëndësishme në hulumtimet që kanë mungesë të fondeve. Për të operuar në universitete duhet pasur kapacitete të fuqishme hulumtuese për ta përmirësuar cilësinë e arsimit të lartë", ka shtuar Beaumont. Kurse Fehmi Zylfiu nga Ministria e Financave ka theksuar se qëllimi i formulës së re të financimit është krijimi më efikas i planifikimit të buxhetit.